

## QËMTIME PËR JETËN DHE VEPRËN E VEPRIMTARËVE PEDAGOGJIKO-ARSIMORË TË FESË ISLAME NË ULQIN

*Jeta dhe vepra e hafëz ALI RIZA ULQINAKUT (1855 – 1913)*

Në Ulqin, si krijues vlerash kulturore dhe shkollore përmendet hafëz Ali Riza Ulqinaku, i cili ka shkruar “Mevludin”. Në gjuhën shqipe e kanë shkruar “Mevludin”, edhe shkrimtarë shqiptarë, si Hasan Zyko, Ismail Floqi, Haxhi Çiçkaj, Avdullah Konispoli dhe hafëz Ali Riza Ulqinaku. “Mevludi” i këtij të fundit është botuar me titull “Tergume – i Mevlud Ala Lisan Arnavud” (Përkthimi i mevludit në Stamboll) dhe paraqet përkthimin e Mevludit të Sulejman Çelebiut.

Sipas kumtesës me shkrim të Hasan Mavriqit, në Ulqin, nga entet shkollore të Ulqinit, kanë qenë të njohur në këtë pikëpamje Salih - Hylja – efendiu, mësues Haxhi Ymeri efendiu nga Prizreni dhe të tjerë. Nga entet shkollore të Ulqinit, në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, punojnë vazhdimisht shkolla fillore në gjuhën serbokroate dhe mejtepi në gjuhën turke. Deri sa ishte student i Medresesë së Ulqinit, hafëz Aliu e përktheu “Mevludin” në gjuhën shqipe. Para se të shpërngulej në Shkodër, ai mori mbiemrin sipas vendlindjes Ulqinaku. Me punimet e veta, hafëz Ali Riza Ulqinaku u paraqit si njohës i Kuranit dhe i disiplinave të tjera fetare, i gjuhës arabe, turke dhe shqipe.

### Shënime biografike

Hafëz Ali Riza Ulqinaku u lind në Ulqin në vitin 1855, në familjen e një barkëtari, që banonte në lagjen Rana pranë bregut

të detit. Babai i tij quhej Jakub Behluli, prej fisit Usta Ali. Në Ulqin e thërrisnin hafëz Ali Gjoku, se familja njihej edhe me këtë emër. Mësimet i filloi në Ulqin te myderrizi Sali ef. Hylja. Në Medresenë e Ulqinit mësimet i ka ndjekur deri në librin Fenari. Me rënien e Ulqinit nën Mal të Zi, më 1880 familja e tij emigroi në Shkodër bashkë me 413 familje të tjera që u shpërngulën nga Ulqini. Në kohën kur iu lehtësua pikëllimi dhe mjerimi i madh, që e dërrmoi moralisht e materialisht familjen e tij, hafëz Aliu vendosi të vazhdonte mësimet në Medresenë e Shkodrës dhe aty e mori ixhazetin (diplomën e medresesë). Pas kryerjes së Medresesë në Shkodër, hafëz Aliu, në vitin 1882, emërohet mësues i shkollës fillore në lagjen Dudas të Shkodrës.

Hafëz Ali Ulqinaku, në fillim ka punuar si imam dhe myfti në Ulqin. Në kohën e agresionit të Malit të Zi kundër Ulqinit (1876 - 1878), hafëz Ali Ulqinaku mori pjesë në luftën për mbrojtjen e qytetit.

Pasi kreu Medresenë në Shkodër, hafëz Ali Ulqinaku punoi si mësues në këtë qytet. Pastaj, nga Shkodra shkoi në Lezhë, punoi si myfti dhe myderris. Hafëz Aliu vdiq në Shkodër më 23 prill 1913. Është varrosur në xhaminë e Shaban - efendisë në Mahallë të Re. Varri i tij sot nuk gjendet.

Hafëz Ali Ulqinaku ishte atdhetar i shquar, poet i talentuar, përkthyes i shkëlqyeshëm, leksikograf i dalluar dhe alim i nderuar në rrethin ku jetoi e veprroi. Njerëzit që e njohën, thonë se ka qenë bejtexhi i talentuar, kurse njëri prej tyre, hafëz Hasan Mavriqi, thotë: "Ka qenë i zoti, sidomos si shair. Letrën ka pas mujt me e ba në bejte".

### Veprimtaria letrare

Hafëz Ali Ulqinaku në veprat e tij nënshkroi me pseudonimin: Ali Riza. Ai ka lënë disa vepra, të botuara dhe dorëshkrime. Ka botuar një përmbledhje me tri vepra të veçanta: 1) Përkthimin shqip të veprës turke "Huda Rabbim", 2) Mevludin me titull: "Terxheme - i mevlud ala lisani arnaud" dhe 3) Një fe - rrëfenjë me titull: "Mexhmuat - ul - avah". Në dorëshkrim ka lënë një "Abetare" shqipe dhe tre fjalorë që i quajti "Ulqin". Viti i botimit i përmbledhjes së përmendur nuk është shënuar as në faqen titullare

e as gjetiu, pos siç thotë vetë hafëz Ali Ulqinaku në parathënien e fjalorit me titull: "Bedi - ul - Mukattar", përmbledhja e tij u botua me lejen e Ministrisë së Arsimit në vitin 1302 (1884 - 1885). Është një fjalor në vargje turqisht - shqip.

Fjalori "Bedi -ul - Mukattar" ka një parathënie me rëndësi. Parathënia që hafëz Ali Riza Ulqinaku e shkroi në fillim të fjalorit të parë "Bedi - ul - Mukattar", është shkruar në gjuhën arabe më 22 dhjetor 1905. Kjo parathënie është edhe autobiografia e tij.

Vepra "Huda Rabbim" për herë të parë e botua më 1306 (1889) dhe prej këtij viti deri në vitin 1898 është ribotuar dhjetë herë. Është shumë interesant të theksohet se përkthimi shqip i veprës "Huda Rabbim", që bëri hafëz Ali Riza Ulqinaku, është botuar katër vite para se të botohej në gjuhën turke.

Përveç kësaj përmbledhjeje të botuar, hafëz Ali Riza Ulqinaku hartoi një abetare dhe tre fjalorë, që kanë mbetur në dorëshkrim. Fjalori i parë, që mban titullin "Bedi - ul - Mukattar", është hartuar në vargje sipas metodës së aplikuar për të parën herë në letërsinë e vjetër turke nga poeti mistik Shadini - Ibrahim Dede.

Fjalori i dytë, "Axihib - ul - mendar", është fjalor alfabetik turqisht - shqip, ndërsa fjalori i tretë, "Garib-ulme Osar", është fjalor shqip - turqisht. Ky fjalor paraqet më tepër interes dhe përbëhet prej 4000 fjalëve dhe është më i gjati që ka 915 faqe, ku janë dy shtylla, e një shtyllë ka dy kolona - njëra turqisht e tjetra shqip.

Si kryevepër e hafëz Ali Riza Ulqinakut merret "Mevludi Sherif". Fjala është për Mevludin e poetit të shquar turk Sylejman Çelebiut, të cilin ai e përktheu në gjuhën shqipe. Përkthimin e tij ai e bëri në Ulqin në moshë të djalërisë, në vitin 1873 - 1874.

Lëndën për hartimin e fjalorëve të tij, hafëz Ali Riza Ulqinaku e ka marrë nga vendlindja e tij, pra nga e folmja e Ulqinit. Në kohën kur hafëz Ali Riza Ulqinaku i harton fjalorët, ishte tendenca e shkrimtarëve tanë të Rilindjes që të përdornin vetëm fjalë shqipe, duke kuptuar në këtë purizëm përjashtoheshin nga gjuha fjalët e huaja, sidomos të atyre orientale.

Punën më të madhe rreth fjalorëve të hafëz Ali Riza Ulqinakut gjithsesi e ka bërë gjuhëtari e orientalisti i shquar O. Myderrizi, i cili më 1961 në BUSHT boton një punim me titull: "Fjalori shqip - turqisht i hafëz Ali Riza Ulqinakut", ku shkruan për jetën dhe

veprat e hafëz Ali Riza Ulqinakut, jep disa vështrime gjuhësore të gjuhës së Mevludit dhe të fjalorëve të hafëz Ali Riza Ulqinakut duke i krahasuar me të folmen e Ulqinit.

O. Myderrizi, duke e parë vlerën e rëndësishme e madhe që kanë fjalorët e hafëz Aliut për studimin e shqipës, sidomos për dialektologjinë shqiptare, e transkriptoi fjalorin shqip - turqisht dhe e botoi në dy vazhdimë në "Studime filologjike", duke bërë shpjegimin e disa fjalëve të panjohura, dhe kështu mundësoi që ky fjalor të përdorej nga një qark më i gjerë njerëzish për njohjen e studimin e atij fjalori.

Në vitin 1970, në Podgoricë (Titograd) u botua "MEVLUDI SHERIF" në gjuhën shqipe, hartuar prej hafëz Ali Riza Ulqinakut, ribotuar me vendimin e Kryesisë së fesë Islame në Republikën e Malit të Zi. Në parathënie të "MEVLUDI SHERIF" theksohet se përveç "MEVLUDIT", hafëz Ali Riza Ulqinaku, shkroi jetën e profetit Muhamed (a.s). Ai ka shkruar edhe jetën e Ahiretit dhe "Bazat fetare të islamizmit".

Botimi i parë i Mevludit në gjuhën shqipe shfaqet në Stamboll në vitin 1879.

### **Veprimtaria shkencore**

Parathënia që hafëz Ali Riza Ulqinaku paraqiti në fillim të fjalorit të parë "Bedi - ul - Mukattar", e hartuar në gjuhën arabe më 22 dhjetor 1905 njëherit është edhe autobiografia e hafëz Ali Ulqinakut. Kjo parathënie, përveç që hedh dritë në jetëshkrimin e autorit, korrigjon edhe disa gabime dhe lajthitje që janë bërë nga studiuesit e veprës së hafëz Ali Ulqinakut e sidomos gabimet e bëra në konstatimin e vitit të botimit të Mevludit të tij. Nga autobiografia e hafëz Ali Ulqinakut mësojmë se ai i hyri hartimit dhe shqipërimit të veprave që na ka lënë, i motivuar nga ndërgjegjja e lartë që kishte për gjuhën amtare dhe lëvrimin e saj, si dhe nga qëllimi fisnik i arsimit të masës së gjerë të popullit. Gjuha shqipe, thotë autori, ka mbetur e pashkruar dhe e papërdorur dhe kështu duket si e ngrirë dhe e vdekur midis gjuhëve të tjera. Nuk i gjen njeriu ndonjë të metë kësaj gjuhe, vazhdon ai, "veçse kishte nevojë për ca shkronja dhe shënja".

Mevludi i hafëz Ali Ulqinakut konsiderohet se është mevludi

i parë i botuar në gjuhën shqipe. Ky mevlud u përhap bujshëm në Shqipërinë Veriore, sidomos në Shkodër dhe në Malësinë e Mbishkodrës, por depërtoi edhe në Kosovë e Maqedoninë Perëndimore; në Opojë, fjala vjen, këndohet edhe ky mevlud, ani pse shumë më rrallë se mevludi i Tahir Gjakovës.

Më 1933 mevludi i hafëz Ali Ulqinakut u ribotua me alfabetin e gjuhës shqipe me një parathënie, që e shkroi djali i tij, hafëz Said Ulqinaku, imam në Lezhë. Mevludi i hafëz Ali Ulqinakut u ribotua edhe herë të tjera, por është me interes të vihet në dukje një rast i ribotimit të këtij mevludi, siç vërejmë nga disa të dhëna që i jep z. Nexhip P. Alpani. Ai, duke bërë fjalë për mevludet, e veçon një e për të cilin thotë: “S’është bërë fjalë deri më sot në studimet përkatëse, që është botuar më 1922 nga shqiptari Nazmi Hilmi. Shqipja që është përdorur në të, është një e folme lokale, me shumë terma e shprehje fetare arabisht dhe fjalë osmano – turke”. Të dhëna të tjera për këtë mevlud Alpani nuk jep, por na e thotë mendja se këtu është fjala për një ribotim të mevludit të hafëz Ali Ulqinakut, që do ta ketë bërë ndonjë shqiptar, i cili për autor gabimisht do ta ketë marrë kronogramin në fund të parathënies osmanisht të Mevludit, fq. 3. Ky kronogram përbëhet nga fjalët “Arnaut Nazmi Xheli” (tek. arab) që ka kuptimin: vjersha e shkëlqyer shqipe. Kur të llogaritet ky kronogram sipas ebxhed – llogarisë del viti 1295/1878 që edhe figuron nën këtë kronogram, i cili nuk e tregon vitin e botimit të përmbledhjes së hafëz Ali Ulqinakut, por tregon vitin e përkthimit apo shqipërimit të veprave.

Ylemaja e Shkodrës, që e kishte parë mevludin e hafëz Ali Ulqinakut, i kishte propozuar të përkthente veprën “Huda Rabbim”, gjë që ai e pranoi. Pasi hartoi fjalorin e tij të parë për qëllime didaktike, ata i propozuan të bënte një fjalor tjetër të mirëfilltë. Në autobiografinë e tij, hafëz Ali Ulqinaku lidhur me këtë thotë: “Sadoqë s’e pashë vetëhenë të zoti për këtë gjë, e pranova urdhërin e tyre, se, përlulja përpara dëshirës së të mëdhenjet është një prej nevojave të edukatës, dhe ata që përukenë jan’ në syt të mëshirës së Zotit. Porse gabuanë duke mejtuarë që unë jam i zoti, kurse kapitali im është fort i pakët, edhe nga pandehma e tyre unë jamë fare lark; desha vetëm që t’i bindem urdhërit, edhe me gjithë që thashë se i urdhënumi nuk ashtë ma

i ditun se urdhnusi, fillova...”.

Hafëz Ali Ulqinaku, ndonëse ishte modest në vlerësimin e aftësive të veta, ylemaja e Shkodrës do t’ia ketë njohur realisht aftësitë, sepse më shumë se fjalët që i tha për vete, flasin veprat e tij.

Hasan Kaleshi mendon se mevludi i hafëz Ali Riza Ulqinakut është mevludi i parë në gjuhën shqipe.

Mevludi i Ali Riza Ulqinakut mban titullin në gjuhën osmane “Terceme - I mevlud - I ala lisan - 1 arnavud” (Përkthimi i mevludit në gjuhën shqipe). Siç shihet në vetë titullin, edhe ky mevlud është përkthyer nga ai i Sylejman Çelebisë me disa vargje të veta. Mevludi është botuar më 1295/H. (1879), ndërsa sipas H. Kaleshit viti është gabuar dhe është datuar 1878, edhe tek Osman Myderrizi datën e këtij mevludi e gjejmë të vitit 1879.

Është me rëndësi të veçohen vargje të mevludit të hafëz Ali Riza Ulqinakut për të vërtetuar vetëdijen kombëtare të hafëz Ali Ulqinakut, të cilin e shpreh në parathënien e mevludit:

- Arnaudçe me qerem të Zotit u lenis (hartuar)
- ishit një gjuh që kalam s’ish kollanis. (përdor)
- Kushda qi ta ven hesab donji hata (gabim)
- mej gadit aj qi ta shof i banj rixha (i lutem).

\* \* \*

Sipas studiuesit Lumo Skendo, hafëz Ali Riza Ulqinaku i përkiste shkollës letrare dhe shkencore shqiptare të traditës islame (e cila për shkrim përdori grafinë arabo - osmane), të njohur në letërsinë shqipe me sintagmën bejtexhinj dhe pas vetës ka lënë një opus të gjerë veprash letrare, përkthime shqipe dhe origjinale, mandej fjalorë shqip - turqisht dhe turqisht - shqip dhe vepra me karakter filozofik islam, midis të cilave: një Mevlud; një Abetare shqip; një Libër të imituar prej Tuhfe - I Vehbije në vjershë, me frazë dhe fjalë turqisht - shqip; një Fjalor shqip - turqisht me 133 faqe me rreth 5500 fjalë; një Fjalor turqisht - shqip me 435 faqe me afro 18 mijë fjalë.

Lumo Skendo përfundonte: “Po i japim këta përskrime nga frika se mos çdukenë një ditë dorëshkrimet dhe humbet edhe kujtimi i tyre”.

Frika e L. Skendos me gjasë kishte bazë. Një e dhënë nga viti 1936, nga i biri i hafëz Ali Riza Ulqinakut, hafëz Said Ulqinaku,

përpos “MEVLUDIT SHQIP” e zuri ngoje vetëm “nji fjaluer Shqip - Turkisht e nja dy vepra të vogla”, pa ua përmendur emrin. Hafëz Saidi për të atin do të konstatojë: “I ndjeri hafëz Ali kishte me vedi një shpirt të madh të pajisun me nji kulturë të naltë thelogjike, me natyrë të mprehtë poetike e me ndërgegje të kullueme dhe të edukueme si mbas parimeve t’Islamizmës”.

Problemin e hulumtimeve të dorëshkrimeve të hafëz Ali Riza Ulqinakut, Lumo Skendo më fuqimisht e shtroi më 1928. Ai ka botuar disa fragmente nga parathënia arabisht e veprës “Bedi -yl - Muakattar”, u ndal më gjatë në tekstin bazë të veprës - fraza turqisht të përkthyer shqip. Kjo vepër dhe disa të tjera leksikografike e pedagogjike janë shkruar pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe janë fryt i rebelimit të tij shpirtëror si njeri i mbështjellur me xhyben e imamit. I biri i tij, Saidi, do të konstatojë: “Ky njeri i lindun jo në kohë të përshtatun me idealet e tij sillte vërdall nëpër Shkodër për të gjetur ngushllimin e atdheut qi kishte humbë. Mjerisht kronika e ngjarjeve dhe rrethanat nuk i nepshin asnjë shpresë. Edukata morale nuk e lejonte me derdhë vnerin e dishprimit ashtu si e bajnë shumë poetë. Prandaj ky u tërhoq në nji anë dhe kapi rrugën mistike për të ngushllue shpirtin e vet. Edhe me të vërtetë këtu e gjeti dermanin”.

### **KADIU - HAFËZ HUSEIN S. MUJALI (1854-1940)**

Hafëz Husein S. Mujali, u lind dhe vdiq në Ulqin. Shkencat teologjike i kreu me sukses të madh ke myderrizi i njohur haxhi Sali ef. Hylja, nga Shkodra, kurse hifzin e kreu te haxhi ef. Tirana, në Ulqin. Pasi kreu shkencat teologjike, në vitin 1879, hafëz Husein S. Mujali kaktohet imam dhe mualim në Ulqin, e pastaj, në vitin 1909, caktohet gjykatësi i sheriatit (kadiu), kurse në vitin 1919 emërohet myfti i Ulqinit, ku qëndroi deri në vitin 1923, kur edhe pensionohet si myftiu i Ulqinit.

Mejtepi dhe Medresja e Ulqinit me Husein S. Mujalin përgatiti kuadër për aktivitet të gjithanshëm kulturor e kombëtar. Nxënësi i hafëz Husein S. Mujalit ishte hafëz Hasan J. Mavriqi, si dhe hafëz Hamit Buzuku etj. Një segment të veprimtarisë së vet ia kushton edhe jetës, veprës dhe mirësisë shpirtërore të njerëzve të shenjtë,

siç ishte Muhamedi a.s. Hafëz Husein S. Mujali e studioi mirë Kuranin dhe fjalët e profetit Muhamed, sepse në ligjëratat e tij, shihet se është frymëzuar prej mësimëve të Kuranit dhe mësimëve të Profetit. Biblioteka private e hafëz Husein S. Mujalit ishte e pasur me literaturë fetare në gjuhën turke, arabe dhe në gjuhën persishte, si dhe me literaturë tjetër nga e Drejta e Sheriatit.

Veprimtarinë fetare, hafëz Husein S. Mujali e filloi në vendlindje si imam, hatib, kadi, hafëz dhe vaiz (ligjërues) në disa xhami të Ulqinit. Duke dëshiruar që të ndihmojë rininë e Ulqinit dhe t'i japë ndihmesë fesë islame, hafëz Husein S. Mujali themeloi shkollën që ishte e njëjtë me gjimnazin e ulët. Diçka më vonë ai themeloi edhe Medresenë e Ulqinit, në të cilën u caktua si myderriz (profesor). Njëkohësisht ai ishte edhe kryetari i Këshillit Vakufor në Ulqin, ku u interesua për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë vakufore. Hafëzi dhe kadiu i Ulqinit - Husein S. Mujali ishte shumë i aftë dhe kishte paradispozita për krijues, çka shihej nga ligjëratat që i mbante para nxënësve të mejtepit dhe Medresesë së Ulqinit. Ishte person me një autoritet të madh në popull dhe në pushtet, një njohës i vërtetë i literaturës fetare e filozofike arabe e turke dhe një krijues i shquar në gjuhën turke dhe shqipe. Krahas shqipes, serbishtes dhe turqishtes, ai zotëronte edhe gjuhën arabe, kuranore dhe persishten - gjuhën e poezisë islame.

### **HAFËZ HASAN J. MAVRIQI (1884-1969)**

Hafëz Hasan J. Mavriqi, u lind në Ulqin dhe vdiq po aty. Pasi kreu shkollën fillore, regjistrohet në mejtepin e Ulqinit duke u përgatitur për hoxhë. Pas shkollimit në Ulqin, në vitin 1898, shkon për studime në Stamboll, ku qëndroi deri në vitin 1910.

Në Stamboll studion në Fakultetin Teologjik, duke kryer njëkohësisht Të Drejtën e Sheriatit Islam, duke u mbështetur besnikërisht dhe fuqimisht në mësimet kuranore të Hadithit e të Sheriatit Islam. Pasi u kthye në vendlindje (Ulqin), punoi si imam shtetëror deri në vitin 1924, dhe në të njëjtin vit, bëhet sekretar i myftiut Husein Mujalit. Në periudhën 1925-1930, kaloi në detyrën e re, si myftiu i qarkut të Tivarit dhe Ulqinit. Prej vitit 1946 deri në vitin 1968, ishte në postin e kryetarit të Bashkësisë së fesë Islame

në Ulqin dhe anëtar i Bashkësisë Islame të Malit të Zi.

Mejtepi i Ulqinit me hafëz Hasan J. Mavriqin përgatiti kuadër për aktivitet kulturor e kombëtar të gjithanshëm. Në këtë mejtep dhe në Medresenë e Ulqinit, krahas shkrim-leximin shqip dhe krahas mësimëve fetare zhvilloi edhe njohuri mësimore nga dituritë ekzakte, natyrore e historike.

Një segment të veprimtarisë së vet ia kushton edhe jetës, veprës dhe mirësisë shpirtërore të njerëzve t1 shenjtë, siç është në këtë radhë Muhamedi a.s., dhe përkatësit e tij. Hafëz J. Mavriqi e ka studiuar shumë mirë Kuranin dhe fjalët e profetit Muhamed, sepse në ligjëratat e tij shihet se është frymëzuar prej mësimëve të Kuranit dhe të Profetit.

Biblioteka private e Hafëz J. Mavriqit ishte e pasur me literaturë fetare në gjuhën turke, arabe dhe në gjuhë persishte, si dhe me literaturë tjetër nga e Drejta e Sheriatit.

Sipas kumtesës me shkrim të Hasan J. Mavriqit, në Ulqin, nga entet shkollore të Ulqinit, kanë qenë të njohur në këtë pikëpamje Salih-efendiu, mësuesi Haxhi Ymer efendiu nga Prizreni dhe të tjerë. Nga entet shkollore të Ulqinit, në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX punojnë vazhdimisht shkolla filllore në gjuhën serbokroate dhe mejtepi në gjuhën turke.

Veprimtarinë fetare hafëz Hasan J. Mavriqi e filloi në vendlindje, në Ulqin, si imam, hatib dhe vaiz (ligjërues) në Xhaminë e Nemezgjahut. Duke dëshiruar që të ndihmojë rininë e Ulqinit dhe t'i japë ndihmesë fesë islame, hafëz Hasan Mavriqi themeloi shkollën që ishte e njëjtë me gjimnazin e ulët. Diçka më vonë, hafëz Mavriqi themeloi edhe medresenë, si shkollë e mesme fetare në të cilën, në vitin 1912, u caktua për myderriz (profesor). Në vitin 1924, sipas vendimit të Ministrisë së Fesë në Beograd, hafëz Mavriqin e caktuan myfti të qarkut të Tivarit dhe të Ulqinit me qendër në Tivarin e Vjetër, ku qëndroi deri në vitin 1930, dhe në këtë vit ai pensionohet. Njëkohësisht ishte edhe kryetari i Këshillit Vakufor në Tivar, ku u interesua për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë vakufore. Po ashtu, në të njëjtën kohë kreu edhe detyrën e imamatit dhe hatibit në Xhaminë Omerhoxhiqa në Tivar të Vjetër.

## HAFËZ JUSUF CUNGU (1874-1952)

Hafëz Jusuf Cungu u lind në Mahallën e Re të Ulqinit, më 1874, vdiq më 10 janar të vitit 1952, në moshën 78 vjeçare. Ai ishte dashamir i arsimit dhe veprimtarisë pedagogjike të fesë islame. Në moshën 10-vjeçare regjistrohet në mejtep, të cilin e kreu me sukses, pastaj vazhdoi mësimet në hulumtimin e hifzit në Medresenë e Ulqinit, ku ligjëronte hafëz Abdu-Rahman Resulbegu nga Ulqini. Pasi e kreu po ashtu me sukses hifzin, vazhdon mësimin te hafëz Husein Mujali, myfti i Ulqinit, ku tregohet si nxënësi më i dalluar.

Me vendimin e myftiut të Malit të Zi, El-Hazhi Mustaf Hilmije-Tigvesli-Maqedonas, në vitin 1897, u bë imam në Xhaminë e Nemezgjahut në Ulqin. Ishte shumë i aftë dhe kishte paradispozita për krijues, çka shihej nga ligjëratat që mbante para nxënësve të mejtepit dhe medresesë, që ai e drejtoi deri më 1936, kur si imam u pensionua.

Hafëz Jusuf Cungu ishte person me një autoritet të madh në popull dhe në pushtet, në të gjitha kohët, siç thoshte populli, një njohës i madh i literaturës fetare e filozofike arabe e turke dhe një krijues e mendimtar i shquar në gjuhën turke.

Hafëz Abdu-Rahman Resulbegu shihte personalitetin te hafëz Jusuf Cungu, përmes të cilit do të tregonte në vepër për rolin e familjes në edukimin human e patriotik të njeriut, të personalitetit.

Hafëz Jusuf Cungu iu kushtua kryesisht literaturës filozofike e letrare dhe mësimin të gjuhëve. Krahas shqipes, serbishtes dhe turqishtes, mësoi gjuhën arabe, kuranore dhe persishten, gjuhën e poezisë islame. Në mejtepin dhe Medresenë e Ulqinit, hafëz Jusuf Cungu do të mbajë ushtrimet me nxënës, me talebe. Në të njëjtën kohë u përgatit për hafëz. Pasi mësoi Kuranin në tërësi dhe i përvetësoi komentimet për ajetet sipas shpjegimit të hafëz Abdu-Rahman Resulbegut, Jusuf Cungu iu shtrua komisionit për provimin përkatës për hafëz. Mbrojtja u bë publike në Medresenë e Ulqinit, pranë Komisionit, të përbërë prej këtyre anëtarëve: hafëz Husein S.Mujali, hafëz haxhi ef. Tirana dhe hafëz Ali Riza Ulqinaku.

## HAFËZ ABDUL BUZUKU (1888-1963)

Hafëz Abdul Buzuku u lind në Ulqin dhe vdiq në Ulqin, në moshën 75-vjeçare. Shkencat teologjike i kreu me sukses të madh të myderrizi i njohur haxhi Sali ef. Hylja nga Shkodra dhe të hafëz Husein S. Mujali, kurse hifzin e kreu të haxhi ef. Tirana në Ulqin. Po ashtu regjistrohët në Medresenë e Ulqinit, të hafëz Husein S. Mujali dhe haxhi Sali ef. Hylja nga Shkodra. Medresenë e Ulqinit e kreu me sukses.

Një segment të veprimtarisë së vet ia kushton edhe jetës, veprës dhe mirësisë shpirtërore të njerëzve të shenjtë, siç ishte Muhamedi a.s. Hafëz Abdul Buzuku e studioi mirë Kuranin dhe fjalët e profetit Muhamed, sepse në ligjëratat e tij, në disa mejtebe të Ulqinit, diçka më vonë, së bashku me hafëz Hasan Mavriqin dhe hafëz in (kadiu) Husein S. Mujalin, në Medresenë e Ulqinit, shihet se është frymëzuar prej mësimëve të Kuranit dhe të Profetit.

Veprimtarinë fetare, hafëz Abdul Buzuku e filloi në vendlindje si imam, hatib, hafëz dhe vaiz (ligjëruës) në disa xhami të Ulqinit, duke dëshiruar që të ndihmojë rininë e Ulqinit. Ishte person me një autoritet të madh në popull dhe në pushtet, një njohës i vërtet i literaturës fetare e filozofike, arabe e turke dhe një krijues i shquar në gjuhën turke dhe shqipe. Krahas shqipes, serbishtes dhe turqishtes, ai zotëronte edhe gjuhën arabe, kuranore dhe persishten - gjuhën e poezisë islame.

## HAFËZ HALIL HOXHA (1877-1958)

Hafëz Halil Hoxha u lind në Ulqin dhe vdiq në Ulqin, në moshën 81-vjeçare. Pasi kreu shkollën fillore, regjistrohët në mejtepin e Ulqinit duke u përgatitur për hoxhë. Pasi kreu shkollimin fillestar, ai vazhdoi mësimet fetare në Medresenë e Ulqinit, të hafëz Husein S. Mujali, haxhi ef. Sali Hylja dhe hafëz Ali Riza Ulqinaku. Mejtepi dhe Medreseja e Ulqinit me hafëz Halil Hoxhën përgatiti kuadër për aktivitet kulturor e kombëtar të gjithanshëm.

Veprimtarinë fetare e filloi në vendlindje si imam, hatib, hafëz dhe vaiz (ligjëruës) në disa xhami dhe mejtepe të Ulqinit. Hafëz Halil Hoxha ishte njohës i mirë i literaturës fetare e filozofike arabe e turke.

## HAFËZ SAID MUJALI (1897-1957)

Hafëz Said Mujali ishte imam në Ulqin prej vitit 1920. U lind në Ulqin në vitin 1897. Babai i tij, Husejn Mujali, ishte kadiu i Ulqinit. Vdiq në Ulqin në vitin 1957, në moshën 61-vjeçare.

Në moshën 10-vjeçare regjistrohet në Mejtepin e Ulqinit, të cilin e kreu me sukses të lartë, pastaj vazhdoi mësimet e hifzit te Hafëz Alush Lllunji në Ulqin. Pasi kreu hifzin vazhdoi mësimin fetar te myderrizi dhe hafëz Hasan Mavriqi në Ulqin.

Me vendimin e Bashkësisë Islame të Ulqinit, hafëz Said Mujali më 31 dhjetor të vitit 1920 bëhet imam në Xhaminë e Marinarëve në lagjen e Ranës, ku qëndroi deri më 1 janar të vitit 1931, kur Xhaminë e Marinarëve e rrëzoi pushteti malazias. Për këtë arsye, hafëz Said Mujali mbeti pa postin e vetë deri më 31 dhjetor të vitit 1944, kur përsëri kaloi në detyrë të re, si imam në Xhaminë e Lamit në lagjen e Kryepazarit të Ulqinit. Në këtë xhami, si imam, qëndroi deri më 21 tetor të vitit 1955.

### Literatura e shfrytëzuar:

1. Nehat Krasniqi, Mevludet në letërsinë shqiptare me alfabet arab, Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 -31, tetor- nëntor, Prishtinë, 1991.
2. Iljaz Rexha, Roli i Mevludit në ruajtjen e gjuhës shqipe, Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 - 31, tetor - nëntor, Prishtinë, 1991.
3. Muhamet Pirraku, Qëmtime për jetën dhe veprën e hafëz Ali Ulqinakut (1853 - 1913), Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 - 31, tetor - nëntor, Prishtinë, 1991.
4. Muhamet Pirraku, Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1979.
5. Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë, 1983.
6. Sabri Hamiti, Vetëdija letrare, Prishtinë, 1989.
7. Osman Myderrizi, Letërsia shqipe me alfabetin arab, Buletin për Shkencat Shoqërore, 2, Tiranë, 1955.
8. Osman Myderrizi, Hasan Zyko Kamberi, Buletin për Shkencat Shoqërore, 1, Tiranë, 1955.
9. Osman Myderrizi,, Fjalori shqip - turqisht i H. Ali Ulqinakut, BUSHT, Ser. Shk. Shoq., nr. 3, Tiranë, 1961.
10. Osman Myderrizi, Fjalori shqip - turqisht i H. Ali Ulqinakut, Studime Filologjike, nr. 3 dhe 4, Tiranë, 1965.